

BIBLIOTEKA

854-32

č 36

ČELA



skica

814-32

536

Ç E L A

P E R T E J

S Y Z A V E

BIBLIOTEKA E  
BASHKIS GJIROKASTER  
NR. INV

54507

GJIROKASTER 1995

Redaktor: ROLAND ZISI

Korektor letrar: THANAS SUXHO

Piktor: GENTI ÇELA

Shtypur shtypshkronjë Gjirokastër

## P E R S E ...?

Pse ndodh kështu në jetë? Ti jeton i shpenguar duke shfrytëzuar çdo çast të saj. Nuk i njeh lodhjet, vuajtjet, hidhërimet, trishtimet që sjell ajo. Madje as ke menduar se ato mund të vinë e të hyjnë në jetën tënde, pa pyetur nëse i mirëpret apo jo. I shikon këto tek trokasin e mjirëpriten nga jeta e njerëzve të tjerë dhe të duken të largëta, të huaja, duke harruar se je njeri. Shikon në rrugë skena ndarjeje dhe qesh. Sheh lot në sytë e tyre dhe betohesh në vetvehte se ty nuk ka për të të ndodhur kështu, se ti nuk do t'i bësh të lotojnë kurrë sytë e saj, se nuk do t'i kthesh kurrë krahët e do t'i lësh lamtumirën mes rrugës. Ti betohesh, por gabohesh. Kujton se je pregatitur për të, por s'është aspak kështu. Ajo të vjen andej nga ti i pregatituri s'e pret. Të vjen në trajtën e kometës dhe ti kënaqesh duke e kundruar, shijuar atë, netëve të bukura. Të lumturon prania e saj. Pretendon se është e jotja duke harruar se ajo është sa kalimtare, aq dhe spontane. Harron se atë e presin yjësi të tjera, qiej të rinj. Dëshirojnë edhe ata ta shijojnë kometën, të zbukurojnë hapësirat e tyre me prezencën e saj. Për të mos t'i lënë ta presin, lozonjare ajo nxiton drejt tyre. Ti i mbetur vetëm, ti zhytsh në dëshpërim. Kujton vuajtjet e të tjerëve, kujton se je njeri dhe pyet. Përse...?

## LAMTUMIRE NDJENJE

Ata u ndanë. Ndjenjat e tyre, ndofta të dashuruara marrëzisht, tashmë u shkëputën. Ai gjeti shpejt një dashuri tjetër, ndërsa ajo...? Ajo jo! Ndjenja e saj nuk ndahej dot nga e kaluara. Ajo u fsheh diku në shpellat e shpirtit të saj dhe mezi priste të ritakonte dashurinë e parë. Priste në ankth gati për të shpërthyer. Buzët e saj zgjateshin të përgatitura për çastin, por çasti po vononte. Ndofta ai s'kish për të ardhur kurrë. Ndjenja e djalit dukej se ishte shumë e impenjuar me ndjenjën e re. Atëhere...?! Çfarë bën, çfarë bën ajo për t'i rikthyer vëhtes vëmendjen që mendon se meriton. Fantazia e saj del jashtë kufijve të fantazisë. I paraqet për zgjedhje disa variante. Ajo zgjedh. Organizon një mbrëmje. Merr përsipër shumë përgjegjësi. Përpara ndesh shumë vështirësi, por ajo dhe ndjenja e saj nuk i përfillojnë ato. Me ndihmën e saj ia del mbanë. Është e sigurtë në vetvetë. Çasti erdhi. Ajo ngrihet, ecën krenare drejt tij. I fal triumfin e fitores që vetë ia ka përgatitur dhe buzët e ndjenjës prekin faqet e tij. Ato prekin dhe fshehen përsëri në vendin e mëparshëm. Duken të lumturuara se më në fund fituan. Harrojnë ato se në sallë ndodhet edhe një ndjenjë tjetër e cila e dashuron fort ndjenjën tënde. Ndjenja tjetër sheh buzët e ndjenjës sate ek prekin faqet e tij dhe mendon. Lamtumirë ndjenjë.

## PERPARA PASQYRES

I përgjumur iu afrova pasqyrës. Mora në dorë krehërin. Me përtesë fillova të kreh flokët kur...?! E çuditshme! Dikush! Identiku im. Ai të cilin e takoja çdo mëngjes dhe që ishte përsëritës besnik i veprimeve të mia, qëndronte i qelqtë e i ngurtë përballë meje. Me dyshim dhe dëshirë për të shuar kureshtjen gjithnjë e në rritje, e pyeta se kush ishte? Unë jam ti më tha ai duke qeshur. Jo, klitha unë si në torturë. Ti nuk mund të jesh unë. Por ai vazhdonte të këmbëngulte në të qenit unë. Atëhere, mendova të shpjegohesha për ta qartësuar bashkëbisedimin, i cili po hynte në rrjedhë të pa dëshirueshme. «Ti nuk mund të jesh unë, sepse po të ishe unë do të veproje në mënyrën time». I kujtova se nuk po vepronte ashtu. Ai përsëri qeshi. Me pak fjalë u përpoq të më sqaronte se pikërisht kjo ishte pika në të cilën unë nuk arrija ta kuptoja. «Kështu lind konflikti», më thoshte. «Është e vërtetë, që deri dje unë isha përsëritësi yt, por sot! Sot mendova se erdhi koha që ti të njohësh veten, domëthënë mua». Pra kjo është arsyeja e moslëvizjes sime përfundoi ai. Po më habiste! Me të vërtetë fjalët e tij krijuan tek unë një gjëndje çoroditjeje. «Kishte ardhur koha

të njihja veten», S'e kuptoja thelbin e këtij mendimi. Unë e njihja veten. Isha... dhe kjo më mjaftonte, por ai nuk mendonte kështu. «Sigurisht që je..., por kjo s'deshmon aspak se e njeh atë», tha me ton bindës e serioz. M'u desh edhe pak konë që t'i jepja të drejtë. Megjithatë e drejta që i jepja ishte anemike, jo e plotë. Isha dakorë se nuk e njihja veten. Këtë konkluzion e pranoja, por s'mund të mbyllja gojën para atij tjetrit. Mendimit se ai ishte... i vërteti. Ndërruam rolet. Tashmë isha unë që mundohesha ta sqaroja atë. I thashë se egzistenca ime është detyruar të jetojë në tre qenie. I pari isha vetë, i dyti ai, ndërsa i treti, ai i vërteti. Ai nuk më ishte shfaqur kurrë dhe s'dija në do të më shfaqej ndonjëherë. Stërmundohesha për ta ndërgjegjësuar, që asnjërit nga ne fati nuk i kish falur privilegjin për të qënë i vërteti, por stërmundimi po më shkonte kot. Ai nuk donte as t'i dëgjonte argumentat e mia e jo më të binte dakord me ndonjërin prej tyre. Durimi po më dilte jashtë kufijve të tij maksimal. E kuptova që me të ishte e pamundur të kuptohesha, për më tepër në këto çaste kur po humbja edhe kontrollin. Bëra edhe një përpjekje të fundit, e cila sigurisht s'dha rezultat. Së fundi i bindur për kotësinë e bashkëbisedimit me të ashtuquajturën vetvete, me nerva të acaruar e dorë të mbledhur grusht, godita fort

pasqyrën. Ajo u thye. Dora m'u gjakos, por për çudi nuk ndjeva dhimbje, Fytyra e tij e shumfishuar si pasojë e thyerjes, qeshi. Ishte një e qeshur e dhimbshme, më tepër e shtirur se e ndierë. E urreva, i ktheva krahët asaj qenieje që jetonte brenda meje. Duke menduar se ata mbetën atje, u largova. Kokën nuk e ktheva mbrapa.



## ERRËSIRA

Nuk mbaj mend kur filloi. Duhej të kish filluar me mbarimin e shkollës së mesme. Kujtoj vetëm se isha bërë një tip i mbyllur. Jetoja i vetëm në një bodrum të errët, që vetë i kisha vendosur perde të zeza një dritareje, e cila nuk mund të quhej aspak e tillë. Dilja rralë, vetëm netëve pa hënë e yje, sepse edhe drita e tyre e pakët më shqetësonte. Për ushqimin tim kujdesej mamaja, e cila ishte tmerrësisht e shqetësuar nga sjellja ime. Më pyeste shpesh kur më sillte ushqimin, që as vetë s'dija si e haja në kushtet e errësirës absolute për arsyet që më shtynin të sillsha në të tillë mënyrë, që sipas gjykimit të saj nuk ishte aspak normale.

Ah, mama, mama psherëtija unë. Errësira më ndihmon t'i shoh gjërat në dritë. Në dritën e tyre të vërtetë, ashtu siç janë dhe jo siç duket se janë. Gjërat vetë janë të errëta dhe shikimi nën dritë na jep një pamje jo reale të tyre. Duhet errësirë, po, po errësirë për t'i parë në dritë gjërat errësirë. Por ajo nuk më kuptonte...

Është gjithçka si në matematikë mundohesha të shpegohesha më thjeshtë. Në rastin e bashkimit të një pozitive me një negative do të kemi një rezultat negativ. Duhet bashkimj i një negative me

një negative për të arritur tek rezultati pozitiv  
Por përsëri ajo nuk më kuptonte. Për të unë isha  
kthyer në një të çmendur. I çmendur sepse dëshiroja  
t'i shihja gjërat në fytyrën e tyre të vërtetë  
e jo nëpërmjet ngjyimeve të rrema që u jep  
drita.

## C I L A . . . ?

Dola. Errësira kish shtrirë pushtetin e saj mbi gjithëqka. Ecja. Ecja pa patur një drejtim të caktuar drejt të cilit shkoja. Gjithmonë më kish përqyer shëtitja netëve. Errësira më ndihmonte të ndinesna i qetë, i kënjellët. Falë saj mund të harroja, fiakja tej lodhjet, shqetësimet që dita e shkuar më detyronte të mbaja. Shëtitja më gëzonte, lumturonte. Shijoja flladin e freskët, çlodnës, dritën kristalore të hënës, ndriçimin e përhumbur të yjeve, dhe shpirti im magjepsëj, vraponte pas tyre. Ndiqte i kënaqur flladin. Fluturonte drejt dritës, hënës, yjeve. Hynte në shoqërinë e tyre. Qeshte. Harrohej. Dehej nga mëkpritja e tyre, bujaria dhe....! Vazhdonte kjo gjëndje derisa, sytë e mia i drejtoheshin akrepave të orës. E vija re vonesën. Thërrisja të vinte shpirti dhe kthënësja krejtësisht i lehtësuar. E përsërisja këtë veprim çdo natë, që ndonëse monoton më pëlqente. Kështu veprovë ehhe sot. Rastësisht këmbët më futën në brendinë e një pylli të dendur. Po provoja një ndjenjë të re disi enigmatike. Frikë e kënaqësi trazuar. U ula mes një sheshi të rrethuar nga drurët e lartë. Nga ai vend dëshiroja ta kundroja hënën lakuriqe të veshur paksa me rrjetën e formuar nga degët e pemëve. Më pëlqente sipërfaqja e saj e pastër tek thyhej, coptohej nga ftohtësia e degëve. Mundohesha ta paralelizoja këtë

skenë me shpirtin tim. Ngrita kokën drejt hapësirës qiellore ku banonte hëna kur....?! Një vezullim i fortë drite m'i verboi sytë. Në mënyrën më të shpejtë ula kokën. Me gishtat tregues fillova të fërkoj kapa... e syve për të shporur prej tyre imazhin verbues. Vazhdova edhe për disaaste këtë veprim derisa gishtat ia arritën qëllimi. Kur zbatova vendimin për t'i hapur sytë ata ndodheshin përballë njëri - tjetrit. Përsëri fërkova sytë. Më dukej vetja në një ëndërr, por gabohesha. Nuk isha në gjumë dhe ajo që shihja nuk ishte t'ok i krijuar nga imazhi verbues. Ata ndodheshin atje, të vërtetë, të vendosur e kokëfortë. Në duar diçka mbanin. Diçka që më ngjasoi me vezët, megjithëse nuk isha krejt i sigurtë në përcaftimin tim. Errësira e thellë nga njëra anë dhe drita e fuqishme nga ana tjetër m'a përlligjin mossaktësinë. Megjithatë po i quaj vezë. Vezë që në vend të zogut mbanin brenda tyre njerëz. Njerëz që si zogj të pafuqishëm mundoheshin më kot për të çarë celfën robëruese, diku të bardhë, diku të zezë. Ata nën britmat e simpatizantëve të tyre që s'dinë nga mbinë ngrinin duart përballë njëri - tjetrit. Ata... in gati për të përplasur vezët dhe pas një pauze të shkurtër i ulnin prapë. Vetëm ideja e të përplasurit i tmerronte njerëzit rob brënda «vezëve». Shttrin duart. Godisnin me forcat që kishin celfën. Dëshironin t'a thyenin, të çliroheshin për-

fundimisht prej saj, por celfa ishte e fortë dhe i  
bënte të dështonin në çdo tentativë. Përsëritja e  
kësaj skene vazhdoi gjatë. Ngritje duarsh. Britma  
Tmerr pa fund e përsëri ulje duarsh. I mbërthyer  
nga ankthi i pritjes e kurioziteti për të parë fi-  
ndin e skenës pyesja veten. Vallë cila do të thy-  
hej....?!

## V E T V R A S J A

Ishte ora 7.55. Sapo i sha ngritur nga gjumi Shpejt e shpejt u vasha. U nisa për në shkollë. Isha vonë dhe më duhej të nxiroja. Ecja ime nuk duhet të ishte normale. Këtë gjë e vërtetonin dhe vështrimet e pazakonta të kalimtarëve, të cilëve nuk ua vija veshin. E vetmja gjë që më shqetësonte ishte: «A do të arrija më kohë në shkollë». Gjithashtu më shqetësonte dhe fakti se atë mëngjes nuk kisha shkuar në banjë, pra e kuptoni se ç'ndjeja. Pranë shkollës ishte një ndërtesë në ndërtim. U futa atje i vetëdijshëm se nuk ishte banjë publike, por ç'ti bësh nevoja më detyroi. E krewa me nxitim veprimin. Tërhuca me forcë zinxhirin e pantallonave dhe do të kisha vrapuar për në shkollë, në qoftë se nuk do të shikoja atë. U ktheva. Ishte një pamje vërtet tmerruese. Kishte hypur mbi një stol gjysëm të kalbur dhe në hakurat e veshur me një shtresë të hollë ndryshku në vendin që më pas do të ishte tavani i ndërtesës kishte lidhur një litar, i cili përfundonte me një formë ovale.

Skena të ngjashme me këtë kisha parë nëpër filma të ndryshëm, përpara momentit të vrasjes së ndonjë personazhi. Duke e paralelizuar realitetin artistik me atë jetësor, menjëherë kuptova se ai do të varej, se do të varej. Pa kuptuar edhe vetë, diku nga thellësia e brendisë time ndjeva të lindë dëshira për ta shpëtuar këtë të panjohur,

për të mos e lejuar këtë fatkeq e ndofta të përfshirë nga një çast marrëzie ta kryente atë veprim, i cili për mendimin tJM nuk ishte aspak i drejtë. Për të mos e lënë krijesën time të brishtë të vrysokej, po përkundrazi duke u bindur gjithnjë e më tepër se ajo duhej të rritej e fortë e plot shëndet i fola. Ai dukej të ishte tepër i përqëndruar, sepse vetëm kur i fola munda të vinte re prezencën time. Me një zë mbi të cilin qëllimisht theksova dukshëm tonet bindëse i thashë që t'i linte trimëritë e të ulej poshtë. Për më tepër kjo që po bënte nuk ishte aspak e këndshme. E sigurova se do të isha mirënjohës nëse ai do t'i jepte fund gjithë kësaj e do të ulej prej andej. «Ne duhet të diskutojmë i thashë edhe pse mund të të duket absurde për vetë faktin e mos njohjes sonë. Rastësia mbasa me qëllim më solli këtu. Ndofta jeta e ka menduar se ti nuk duhet të vetflijohesh, por të ka ndëshkuar vetëm duke të detyruar të trokasësh në portat e vdekjes dhe në momentin kur rojat e saj të kobshëm të t'i hapin kanatat pa përtuar atëhere, jeta të dërgon dikë për të mos lejuar hyrjen tënde të parakohshme aty», Kuptova se ky dikushi duhet patjetër të isha unë. Në përfundimin e fjalëve të mia pllakosi heshtja. Në pritje të veprimeve për të cilat isha i sigurt se ai do t'i kryente, me çdo mënyrë mundohesha ta afroja sa më shumë fundin e asaj pauze që pse ta fsheh ishte tejet e mërzi-tshme dhe ankth ndjellëse. Po megjithë padëshi-

rën time parashikimet më mbetën vetëm brënda kuadrin të hamendjes. Në vend të veprimeve që unë prisja, ai bëri diçka krejt të kundërt me çka i sugjerova. Me duart tek të cilat s'dallohej as më e vogla pasiguri, afroi lakun pranë qafës, Jo, mos ulërita, sikur ajo dallgë e çmendur vetvrasjeje të kish zgjedhur për breg pushues qafën time e jo të tijën. Ti nuk e zotëron të drejtën t'ja heqësh të drejtën vetes për të jetuar. Kjo që do dhe ke vendosur të bësh përbën një krim dhe mbi të gjitha një mëkat.

Indiferenca e tij u shfaq edhe njëherë kokëfortë, me kalimin e lakut rreth qafës. Pas kësaj ktheu kokën nga vendi ku unë qëndroja si i ngurrosur dhe përplasi buzët. Kuptimi i tingujve që çuqerisht koshienca ime e murrosur mund ende të përcahtënte ishte. «Ajo çka bëj me veten time është një problem i yni dhe aspak i yti. Ti nuk ke haber fare nga drejtësia».

Mendova ta kundërshtoja, t'i tregoja se studjohja për drejtësi, se edhe parimet morale e dënnonin kuptohet me një dënim moral këtë veprim. por ishte vonë, Tashmë pas flakjes që i bëri me guxim, stoli nuk gjendej më poshtë këmbëve të tij dhe ai lëkundej si një lisharës i harruar në pikëllim. Tek e shihja të jepte shpirt në atë gjëndje lëkundjeje, diç ndjeva. Diçka u këput dhe mori tatëpjetën brënda meje, për të ndalur së bashku me forcat e mia pikërisht në atë pjesë të trupit, për të



cilën dyshoja në ishte akoma e jmjja, Me keqardhje e neveri ushqeja ndjenjat e mia për këtë njeri që u vetkthye në kufomë. Keqardhjen për një jetë të humbur dhe neveri për veprimin e ulët e të shëmtuar si pasojë e të cilit u zhduk padrejtësisht ajo jetë në thellësitë e përhumbjes. Ishte një trup i fuqishëm. Ështrat e krahëve i mbuloleshin nga muskujt e mëdhenj dhe brenda asaj koke të rrethuar me shije nga kaçurrelat e zinj më parë duhet të kish funksionuar një tru ndofta inteligjent. Me të drejtë qenien time e mundonte dilema në duhet ta quante të fortë apo të dobët këtë djalosh viktimë, sepse në të vërtetë ajo vetja ime nuk mund ta linte pa e pagëzuar një episodë të tillë, jashtëzakonisht të pazakontë. Më duhet të dilja, ndonëse nuk doja jashtë kornizave të mendimit tim për vetvrasësit, I quaja të dobët, të padenjë për jetën, por po më dilnin të fortë dhe mos kokçarës ndaj saj, Veprimet dhe trupi i atij djalë ishin kundërfakte që s'mund të injoroheshin dhe që të detyronin t'i merrje parasysh! Shpesh herë të pa vetëdijshëm, gjendemi papritmas në krahët e ndryshimit. Mendimet tona të kthyer në bindje dalëngadalë e pa kuptuar ndërrojnë kah dhe v. tëm kur gjendemi në kufijtë e ekstremimit tjetër arrijmë ta kuptojmë ndryshimin. E njëjta gjë po më ndodhte edhe mua. Antiteza forcë kishte zënë vendin e bindjes dobësi, pas një lufte të ashpër të cilën se

kisha kuptuar në lidhje me problemin e vetsakri-  
fikimit, vetmohimit i shprehur në aktin e vetvra-  
sjes. Individit i cili përshkon rrugën tmerrsisht  
të vështirë të këtyre gjendjeve, nuk mund kursesi  
të shprehë përgjatë saj anën e dobët të karakterit  
të tij. Përkundrazi, përballë këtyre ndërlikimeve  
shpirtërore një shprehje dobësie ose qoftë edhe  
pasigurie mund të shkaktojë probleme më të më-  
dha të cilat të bëjnë të përfundosh mes koridoreve  
psikiatrikë, i rrethuar nga përparëse të bardha.  
Sikur të mos egzistonin të gjitha këto, edhe vetëm  
mendimi se vetë arritja e një përfundimi, marrja  
e një vendimi dhe zbatimi i tij mund të bëhen  
vetëm me anë të forcës, do të bëhej mbrojtës i  
gjykimjt tim. Me qetësi në kufijtë e absolute, ai  
kreu një veprim që asnjëri nga ne nuk do të mund  
ta kryente, sado që të justifikohet se është i zoti  
ta përballojë jetën. Ai vendosi ta largonte veten e  
tij nga kjo botë, duke kërkuar diçka tjetër, ndofta  
një botë tjetër. Me anë të këtij veprimi që ne e  
quajmë të shëmtuar ai shpalli pamvarësinë ndaj  
botës, flaku nga trupi i tij vargonjtë e robërisë je-  
tësore...

U largova nga ai vend i tjetërsuar. Duke nxi-  
tuar në drejtim të auditorit shpresoja se ndofta  
një ditë do ta ndjeja veten aq të fortë, sa për t'i  
këputur vargonjtë e kësaj robërie që ma ka sjellë  
në majë të hundës.



54507

## B R E N D A   M E J E

E Shtunë. Mbas daljes nga tualeti kërkova diçka për të ngrënë. Në frigorifer s'kishte asgjë, Më ishte bërë zakon që nga koha që jetoja i vetëm të mos e haja mëngjezin, prandaj kjo prishje zakoni në një farë mase më habiti,

Ishte «weekend» i parë që isha i detyruar ta kaloja vetëm, E dashura më ofroi një mundësi për ta kaluar fundjavën në shoqërinë e familjes së saj, por mua m'u duk më i udhës refuzimi. Mendova se do të mërziqtesha, për shkak se prania e prindit mashkull të saj më nervozonte, ndonëse ai m'udhëzoi të ishte sa më i sjellsëm me mua. I përdorur vendosa të dilja nga dhoma. Nuk mund ta duroja më atë gjëndje urie e mërzie trazuar. Çelsat më nevoiteshin për të mbyllur portën, ishin mbi tavclinë. Shkova t'i marr. Pranë tyre çuditërisht naod ... albumi i familjes sime. Ishte e vetmja gjë që kisha trashëguar nga ajo. Instiktivisht dora derroi destinacion e u ndal mbi kapakun e tij, E hapa. Në fletën e parë ishte fotografia e gjyshes. Po bëheshin gati dhjetë a pesëmbëdhjetë vjet që ajo kish vdekur. Nëse ishin dhjetë apo pesëmbëdhjetë nuk isha fort i sigurtë, por kujtoj se në varrimin e saj nuk kisha shkuar, pra sigurisht që varrin nuk ja dija, Nuk dëshiroj aspak të justifikohem, por që i vogël vendi ku preheshin

jetëpushuarit më kallte tmerrin, prandaj dhe s'kish shkuar. Atëherë kujtova se veprova mirë, por vetëm sot pas kësaj vjetësh e ndjeja mbi ndërgjegje peshën e këtij «faji», Mendimi për të shkuar e riparuar sado pak gabimin e bërë m'u duk disi i mirë. Nga njëra anë nuk dëshiroja ta kaloja fundjavën në një vend si varrezat, ndërsa nga ana tjetër dëshira për të shkuar luftonte me vetmohim mosdëshirën. Duke ndjerë turp para vetes i fala triumfin e fitores dëshirës. Do shkoj binda veten dhe s'vonova të nisesha, Qëllimshëm gjatë rrugës kalova pranë një dyqani lulesh dhe bleva një tuftë nga ato. Ishte hera e parë që shkoja në varreza dhe prezanca e luleve do t'ia shtonte pamjes sime seriozitetin. Atmosfera e varrezave ishte krejt e ndryshme nga e parë paragjykoja. S'kish në të asgjë të frikshme, asgjë që mund të të tmerronte përveç qetësisë. Pa humbur kohë u vura në kërkim të varrit dhe të them të drejtën nuk hoqa shumë për ta gjetur, S'thoshnin kot që isha njeri me fat, U ula me kujdes pranë mermerit mbi të cilin lexohehin qartë gjurmët e kohës. Vendosa lulet mbi të dhe shihja me mallëngjym fotografinë e gjyshes të rënduar gjithashtu nga pesha e viteve, Ngrita dorën për ta përkëdhelur. Diçka doja t'i thoja, kur toka m'u drodh ndën këmbë, Sikur të binte një tërmet ajo filloi të çahet dhe unë u ndodha brënda saj. Menjëherë fillova përpjekjet për të mbledhur veten e për të larguar prej saj hutimin që e kish

pushtuar, pas asaj s'duhet të ishte tjetër veç e-ndërr ose vegim.

Drita që depërtonte nga e çara trazohej me mjegullën e brenda tokës duke krijuar përpara syve të mi atë vërtetësi tronditëse. Veshët e mi ndonëse në të tillë gjëndje arritën të perceptonin një zhurmë të thatë e të mbytur, e cila duhet ta kishte burimin fshehur në thellësitë e mjegullës. Zhurma vazhdonte të mbetej e thatë, por mbytia sa vinte po i humbiste, për t'u zëvendësuar nga një ton më fortë. Dukej sikur dikush po më afrohej. U mundova të dalloj ndonjë gjë mes atij mjedisi dhe mundimi s'më shkoi kot. Siluetat e tyre filluan të qartësoheshin. Nuk doja ta besoja, por ata ishin skelete, po, skelete që lëviznin tamam si në filmat e ciklit «Netët e tmerrit». Po afroheshin me një ecje të ngadaltë, shumë të ngadaltë, duke zgjidhur drejt meje krahët e tyre të shpifur, Shtanga për një moment dhe gjykimi në humbi për disa çaste. Nuk dija çfarë të bëja. Filla të flas. As vetë s'e di se çfarë, por flisja. Shajja. Bërtisja. Ulëria. Cërresha. U thoja të largoheshin, se më vinte ndot prej tyre e gjëra të tjera, të kësaj natyre, por ata nuk donin t'ia dinin për protestën time. E vetmia gjë që u interesonte ishte të më kapnin sa më shpejt dhe për t'ia arritur ecnin. ecnin pa pushim. Distanca sa vinte e shkurtrohej. Dëshiroja shumë të largohesha; të vrapoja drejt së çarës, të ngjitesha mbi të e gj-

thëka të kthehej si më parë, por gjymtyret nuk po me bindeshin. Më vinte me të vërtetë çudi. Ishte hera e parë që më ndodhte diçka e tillë. Muskujt e mi të komanduar nga truri, nuk po mund të lëviznin gjymtyrët e mia. Për herë të parë ato që ishin bërë mbartëse të trupit tim kudo që shkoja po dilnin jashtë kufijve të kontrollit tim. Ndërkaq ata po afroheshin. Ishin me të vërtetë të shpifur. Kafkat e tyre-sepse tani i shihja qartë — dukeshin sikur talleshin me mua. Silleshin sikur ta dinin arsyen e moslëvizjes sime. Siguria e tyre, ndonëse pa dëshirën time, po më bindte për pamundësinë e ikjes nga ai vend. Më dukej llogjike ta përballoja realitetin ashtu siç ishte, pasi mungesa e një mundësie tjetër më privonte mundësinë e zgjedhjes. Duke pritur prekjet e tyre të neveritshme fillova të vras mendjen që të paktën të kuptoja arsyen, psenë. Dhe arsyeja, pseja, kishte qënë e thjeshtë. Që nga prekjet e para të tyre, kur ata pa mëshirshëm filluan të shkulnin pjesë të mishit tim, filloi të zbulohet përgjigja, e cila rrënte fshehur tek unë. E quaja gabim fatal të kujtesës sime dhe më vinte pështirë që të ma kujtonin pikërisht ata, se mbartësi i trupit tim ishte identik me ata që shihja, ndieja.

E pra, unë nuk kisha se si të largohesha. Brënda meje ndodheshin ata. Nuk mundesha!

## MEKAT I ZOTIT

Tashmë për njerëzit e atjeshëm isha i vdekur. Do të më dukej me të vërtetë një budallallëk me brirë një mendim i tillë, në qoftë se nuk do të shihja veten time të shtrirë, të rrethuar nga një mori miqsh, që me sa duket kishin ardhur të më uronin udhë të mbarë. Kishin ardhur të më uronin. Dakort! Po përse qanin? Di që njerëzit nuk qanin në raste urimi, përkundrazi duan të duken sa më të qeshur.

U mundova ta hiqja mëndjen nga këto gjëra. Më mbetej pak kohë për t'u nisur dhe i vetmi mendimi i mirë që më erdhi në ato çaste ishte të nisesha. U nisa pa patur nevojën për ndonjë mjet udhëtimi. Gjithçka ndodhi aq shpejt, sa e vetmja gjë që më bindte se kisha udhëtuar ishte ndryshimi i botëve. Ndjeja keqardhje që nuk shijova asgjë, megjithatë mundchesha ta ngushëlloja veten me mendimin se kjo nuk varej nga unë e duke u përpjekur për të krijuar lloj - lloj imazhesh se si mund të kishte qënë, udhëtim i bukur, a i shëmtuar. Fantazia ime e zhvilluar do të më kish ndihmuar shumë, në se veprimtaria e saj nuk do të ndërpritej nga prania e Atij. Atij që mbante autorësinë e krijimit të gjithësisë. U habita. Isha i habitur në kuptimin më të plotë të kësaj fjale. Deri para pak çastesh nuk kisha besuar në egzistencën e tij. Më ishte dukur diçka absurde, madje

dhe njerëzit të cilët besonin dhe prisnin shpëtimin prej tij më ishin dukur idiotë, por për fat të keq s'ishte ashtu siç mendoja. Ai egzistonte, ndonëse ende nuk doja ta pranoja. Më dukej si fantazëm diçka jo reale, e krijuar enkas për të më rrëzuar bindjen për mos egzistencën e tij. E pyeta se kush ishte dhe mora qëndrim pritës. Jam Ai, më tha, Ai të cilit t'i nuk i ke besuar kurrë, të cilin ti e ke fyer me indiferencën tënde, që e ke injoruar duke mos përfillur. Megjithatë, vazhdoi Ai unë do të të fal, do të fal se jam mësuar t'i fal ata që më shajnë, përbuzin, ofendojnë e sfidojnë.

E dëgjoja me vëmendje, por nuk arrija ta kuptoja arsyen, përse po më falte? Ishte e drejta ime ta ose mos e besoja egzistencën e tij. Mendoja t'ja them, po shpejt hoqa dorë. Ndofta Ai s'dinte gjë për drejtësinë e njerëzve të shprehur në «Kartën e Helsinkit» dhe «Deklaratën e Parisit». E pyeta se përse po më falte? Pyetja ime s'e çuliti aspak. Ishte mjaft i sigurtë në vetvete. Kisha dëgjuar për të se Ai dinte e mund të bënte gjithçka. Kjo më gëzoi sepse pyetja ime nuk do të mbetej pa përgjigje, Më tha se arsyen për të cilën po më falte nuk duhet t'ia kërkoja Atij, por vetes. Kjo nuk është përgjigje, thashë unë. Nëse unë do ta dija përgjigjen nuk do të të pyesja. Ai pohoi duke tundur kokën. Është e vërtetë më tha, por tani ti mund të mendosh dhe të kuptosh gjëra që s'i ke menduar dhe kuptuar më parë.



Kishte të drejtë. Po, sigurisht që kishte të drejtë. Unë si të gjithë njerëzit isha mëkatar dhe Ai po më falte mëkatet, Kishte qënë gjithcka kaq e thjeshtë sa më dukej vetja i trashë që se kisha kuptuar më parë. Të duket vetja i trashë, ndërhyri Ai. «Të thashë që tani do të kuptosh shumë gjëra». Ai kishte mundur të depërtonte mes mendimeve të mia, ndryshe s'kish si shpjegohçj ndërhyrja e tij pikërisht në atë moment. E çuditshme! Nuk ka azgjë të çuditshme vazhdoi Ai. «Unë mund t'i lexoj mendimet në trurin tënd si ti një fjali në letër». S'kisha më asnjë dyshim. Ishte pikërisht Ai. Mund të largohesh më tha. Tani ti nuk je në gjëndje të bësh keq. Mëkatet të janë falur, zëmra jote është pushtuar nga e mira, prandaj shko i qetë.

S'di pse u ngurosa në vend. S'di se çforcë më mbante atje dhe nuk më linte të vrapoja drejt parajsës. Jo thashë i vendosur pas disa çastesh, nuk shkoj. Nuk pranoj të mi fali mëkatet një mëka ar Kjo gjë më duket absurde, përfundova. Ai qeshi, Më tha se nuk po kuptoja se çfarë po flisja. U mundua të më qetësonte duke më treguar dyert e hapura të parajsës, por unë kundërshtoja, kësaj radhe më me forcë. Edhe ti je mëkatar shqiptova zorshëm, ndonëse për nga shkalla e mëkatit nuk mund të krahasohesh me njerëzit, prapë je mëkatar dhe kjo nuk më duket pak apo jo. Vazhdoi të vinte buzën në gaz dhe më pyeti se cili ishte më-

kati i tij sipas mendimit tim. Bëra një pauzë të shkurtër, ashtu siç bëj kur dua të jap një përgjigje sa më të saktë dhe pastaj fola: «Mëkati yt është që krijove botën. Ti bëre mëkatin e parë dhe pastaj mëkati ndoqi mëkatin, derisa tani aty poshtë është bërë një det i pafund mëkatesh. Atje vriten, vidhen, përdhunohen, shkatërrohen njerëz, të cilët kanë vetëm një faj, të qënit njerëz. Gjithçka në mbretërinë që ti krijove është e ndërtuar mbi bazën e padrejtësisë. Po të pyes çfarë bën Ti, Ti i plotfuqishmi për ta ndaluar një katastrofë të tillë? Asgjë! Çfarë bën Ti për t'i çliruar ata të mjerë, të pafuqishëm nga sundimi i djallit? Përgjigja është përsëri asgjë. Ti je i vetmi përgjegjës për çka ndodh aty poshtë dhe kjo përgjegjësi përbën mëkatin tënd të vetëm». Përfundimi i kësaj ligjerate më gjeti të çliruar.

U largova pa e ditur se ç'më priste, para jsa apo ferri. Në fund të fundit ç'rëndësi kishte. Unë e kisha jetuar ferrin e vërtetë.

## BUZE DETIT

Dimër. I ulur pranë dritares kundroja i vetë pamjen që shtrihej përpara meje. Koha ishte e vrejtur. Re të shumta shtynin me forcë njera - tjetrën. Deti ishte i trazuar. Dallgët kryeneçe përplaseshin, ngriheshin lart sikur diç donin të arrinin dhe përsëri uleshin me nevrrikun e një të dështuari. Ky peisazh po më pëlqente, megjithatë kisha përshtypjen se diçka i mungonte. Diçka e vogël, por që do ta plotësonte e zbukuronte atë. Filloi shiu. Ishte i imët. Të gjendurit jashtë u vunë në kërkim të ndonjë strehe. Asnjëri prej tyre nuk kishte aspak dëshirë të lagej. M'u duk diçka e natyrshme dhe mbi të gjitha llogjik e i përligjur, ky nxitim njerëzor.

Isha diplomuar si psikolog dhe gjithçka i shty- të nga pasioni e lidhja me shkencën time. Midis njerëzve dallova dhe dy të rinj, që si të tjerët e dhe ata vraponin. I ndoqa me sy deri sa u zhdukën dhe qesha me vete. Mendja më shkoi menjëherë aty ku unë isha munduar t'ia kufizoja në maksimum atë rikthim nostalgjik. E kaluara më mër- ziste, prandaj vendosa ta largoja mendjen nga kujtimet. Bëra ta shkëput vështrimin nga vendi ku ata humbën, por s'munda. Diç dallova larg atij shkëmbi, duhet të ishte njeri. Kështu të paktën më dukej mua. Njeri, madje i ulur mbi rërën e lagur. S' shihja asnjë mjet mbi të cilin mund të

ishte ulur. Kjo skenë krejt natyrshëm mundi të detyronte interesimin tim. I vëmendshëm paraxaloja si në manifestim veprimet që ai do të kryente. Prisja nga çasti në çast që ai të ngrihej, të shpejtonte në drejtim të ndonjë vendi, por u zhgënjeva. Për çudinë time ai po rrinte pa lëvizur, si të ishte statujë guri e jo njeri. Kurioziteti për ti parë fytyrën e biseduar me këtë statujë mishtore pati ndikim të konsiderueshëm në krijimin e bindjes sime për të dalë.

Mendimi mbi bukurinë e kohës më ndryshoi menjëherë sapo rashë në kontakt me erën dhe pikat e shiut. Ju afrova njeriut, i cili ishte mashkull dhe i fola. Nuk mora përgjigje. Nga mënyra sesi qëndronte dukej se shikonte diçka shumë të rëndësishme, e cila e kishte mbërthyer e s'e linte të lëvizte. I thashë të ngrihej dhe me një ton mbi të cilin kishte më tepër nota lutjeje se sa mirësjelljeje, e ftova në shtëpinë time. Duke e ngushëlluar për padrejtësinë e jetës, mendova ta bindja të rrinte me mua. M'u desh edhe pak kohë që ta kuptoja se po flisja kot, se ato që unë i thoja në kufijtë e përgjërimit nuk i bënin fare përshtypje. I prekur nga indiferenca e tij e kapa nga krahu. Ai ktheu kokën. Ishte i bukur. Flokët e lagur që i vareshin mbi supet e fytyrës e hijeshonin më tepër. Pa humbur kohë e pyeta se ç'është shqetësonte, ç'është detyronte të rrinte e të lagej në këtë shi që për më tepër ishte dhe i ftohtë. Tashmë edhe unë isha

: pa mbrojtur. Çadrën e kisha lëshuar dhe era e pamëshirshme e kish copëtuar pas shkëmbinjve. Ai më sugjeroi të shikoja në brendësi të detit. Unë u binda. Pashë! Pashë, dallgë të harbuara, re çmendarake dhe shkëmbinj xhind, por asgjë tjetër aq interesante sa për të më detyruar t'i qëndroja atje. Bëra edhe një përpjekje tjetër i ndihmuar nga lutja për ta ç'ngurosur atë njeri, por edhe kësaj here dështova. Këmbëngulja e tij vazhdonte ta rriste misterin, që si krymb gryente sipërfaqen e mendimeve të mia. I hodha edhe një vështrim më të hollësishëm sipërfaqes së tërbuar të detit dhe në përfundim të këtij vëzhgimi arrita të zbuloja një shishe që lëkundej mes dallgëve. Të them të drejtën, mendova se ky i mjerë duhej të ishte ndonjë i sëmure psikik, ndofta edhe i çmendur. M'u duk shumë interesante të zbuloja se çfarë misteri mund të shkaktonte një gjë kaq e zakonshme - sepse me të vërtetë e quaja të tillë gjëndjen e një shisheje në det, — tek njerëz të tillë. Instikti i psikologit m'a paraqiste tashmë si detyrën time të depërtoia në mendjen e atij. Ishte puna ime që të hyja thellë mes atyre kanaleve e linjave tmerrësisht të holla, ku pothuaj edhe të gjithë të thjeshtit e jo më të sëmuret e kanë të pamundur të kalojnë. E shihja atë shishe tek fluturonte nga njëra dallgë tek tjetra dhe m'u duk sikur ato qeshnin, luanin, argëtoheshin me tronditjen që i shkaktonte, ndërsa ajo: Ajo qante, vajtonte e pasigurtë në kra-

hët e tija. Pashë edhe reagimin e djalit, kur dallgët duke e lëkundur e nxorrën në breg mbi rërën e squllur. Ah, jeta, pëshpëriti ai i kënaqur me një rënqeshje të hollë mbi buzë, e cila shpejt iu shua, sepse dallgët, e rrëmbyen shishen në krahët e tyre dhe gjithëka filloi përsëritjen. Ajo lëkundej, ngrihej e ulej duke shpresuar më kot për të gjetur pak qetësi mes asaj zhurme. Kjo skenë vazhdoi deri sa dallgët e pa mëshirshme e përplasi pas një shkëmbi të errët. Shishja u thye. Djali u ngrit. Hodhi vështrimin drejt qiellit me kokën e shtrënguar mes duarve dhe zëri i tij doli i fortë, protestë kundër thyerjes. Përse o zot, ulëriti nga thellësia e shpirtit Ai.

Ashtu siç isha në atë amulli moskuptimi ndieva të më pritëshin fuqitë. U lëshova si një degë e thyer nga pesha e dëborës mbi rërën e lagur. Sikur të mos mjaftonte i ftohti i shiut, tani edhe i ftohti i rërës po depërtonte nëpër damarët e mi Ai ngjitej mes hapësirave të ngushta jetike sikur donte të më ngrinte të gjithin. Megjithatë ishte një i ftohtë çuditërisht i ëmbël dhe unë po e ndjeja gjithnjë e më tepër nevojën e tij. Në vendtakimin e të dy temperaturave të ulëta, në trurin tim lindi pa prituri, ashtu siç lind gjithmonë një konkluzion mbi enigmat, përfundimi.

Ne, mendoi mendja ime dhe bashkë me të mendova edhe unë, jemi si një shishe në mes të detit. I gjithë aktiviteti ynë zhvillohet sipas një i-

ntervali të paracaktuar dhe të varur drejt për drejt nga dallgët e jetës. Ndonjëherë ato na marrin e na çojnë në një breg të qetë dhe ne kujtojmë se gjithçka në këtë botë është e bukur e paqësore si t'k ai. Pa dashur, të dhurur nga qetësia e burgosin efektin e tyre në qelitë e të pa ndërgjegjshmes sonë, duke u lënë liridalje vetëm netëve dhe brenda hapësirave të ëndërrave tona. Por, dallgët të nevrikosura nga indeferenca jonë e pa vetëdijshme dhe e ushqyer nga lumturia, kthehen sërish. Na thithin brenda tyre. Luajnë sa duan me ne dhe së fundi, kur tmerri ynë ka qënë i mjaftueshëm aq sa për t'ua larguar zëmërimin, së fundi na pret shkëmbi. Do thyhemi e do çahemi të gjithë. Si ajo shishe edhe ne nuk i shpëtojmë dot shkëmbit. Mundësia është e pamundur.

## BOTA PERTEJ SYZAVE

Kishte disa ditë që nuk arrinte të shihte mirë. Gjithçka për rreth i mjegullohej në disa raste, por ai nuk i kushtonte rëndësi këtij fakti. Ndofta më vjen nga lodhja e madhe nervore, mendonte, por rastet sa vinin e bëheshin më të shpeshtë, derisa ky shqetësim u bë prezent përpara kujdesit të mësuave dhe prindërve. Këta të fundit e detyruan të shkonte tek mjeku. E detyruan, ndonëse ai nuk donte dhe tek e fundit nuk ishte i detyruar të shkonte. Ai shkoi. Trokiti në derë. E hapi atë na pritur të dëgjonte pas saj zërin e zakonshëm që do ta ftonte të hynte. Hyri. U ul. Doktorin e pyeti për shqetësimin dhe ai ia tregoi atë. Doktorin i tha ta priste dhe humbi prapa një derë. Ai e priti, e priti derisa doktorin u kthye me diçka nëpër duar. Diçka që atij i ngjasoi me një skelet syzash të përgjysmuara. Mjeku ja vuri skeletin dhe i tha të shkonte nga tabela në fundin e dhomës. I sëmuri tregoi se u bind duke kthyer kokën anej nga e këshilluan.

Në tabelë ishin të vizatuara disa numura e shkronja, të cilat ai nuk i pa më pas ndezjes së neonit që e quajti «magjik». Doktorin rrudhi buzët dhe me një gjest pakënaqësie fiku neonin «magjik». Pacienti mundi t'i shihte përsëri numrat dhe shkronjat pas këtij veprimi. Filloi t'ia tregonte me saktësi vendodhjen e tyre, por u ndërpre



nga fjala e doktorit. Syzave nuk u shpëton dot, i shpjegoi ai, duke e ndërgjegjësuar për domosdoshmërinë e tyre, e cila do të arrinte deri në detyrim në se si i sëmuri, do të silllej me kokëfortësi. Iu afrua tavolinës dhe rrëmbeu nga sipërfaqja e saj një kuti të mbushur me xhama. Ndezi neonin dhe duke pyetur në kërkim të përmirësimit filloi të vendoste xhama në vendet bosh të skeletit. I vendoste dhe përsëri i hiqte, i shtyrë nga mohimi që bënte pacienti pas çdo ndërrimi. Xhamave optik në kuti po u vinte fundi. Me të drejtë e i shqetësuar doktori po pyeste veten se ç'dreq miope kishte ky djalosh, kur fjala stop e detyroi të ndalej. I kënaqur dhe njëkohësisht i lehtësuar iu afrua tabelës dhe e pyeti se çfarë numri ishte ky tek i cili u ndal maha e shkopit tregues, por s'mori përgjigje. Pamja që shikonte djali nuk përkonte fare me numrin që i tregonte. Tek sipërfaqja e krumit ai shihte diçka tjetër, diçka që e vinte në pozitë e një të vdekuri, përpara të cilit shtrohen për zgjedhje dy alternativa: një jetë ferri e tjetra parajsë. E vetmja gjë që e çudiste ishte se i lihej në dëshirën e tij të vendoste për fatin e tij. Nuk e kish menduar kurrë se do të ishte ai që do të zgjidhte. Përkundrazi, kishte bindjen se do ta detyronin të ndiqte njerën rrugë pa qënë i aftë për të kundërshtuar në rast mospranimi.

Diçka e tillë e lumturoi, sepse menjëherë do të merrte rrugën drejt asaj ku kish shpresuar për

tërë jetën. Sigurisht që mundësinë, për të shkuar atje ku edhe vetë mendimi se një ditë do ta detyronin të shkonte, e eliminoi. Menjëherë nxitoi për andej nga e ndilte zëri i ëmbël i ëngjëllit, por u step. Shpejt u kujtua se edhe vendi ku do të shkonte, nuk përbënte pikërisht dëshirën e tij të vërtetë. Vetë karakteri i tij s'mund të përshtatej me asnjërën prej këtyre mjediseve. Lirinë e robërinë absolute dhe çdo gjë tjetër të tillë nuk e pëlqente. E kuptoi se në asnjërën prej këtyre ekstremeve nuk do të ishte i lumtur. E ndiente se ëndërra e tij do të mund të realizohej vetëm në ambientin tokësor.

I flaku përtej ftesat e pasqyruara në xhama dhe doli me rrëmbim. Jashtë jeta e vërtetë po e priste!

## P E R F U N D I M

Po, janë të shumtë njerëzit që shqetësohen, rrinë pa gjumë për një arsye që më duket e kotë. Mundohen të kuptojnë, krijojnë gjithëfarë imazhesh, iluzionesh, për diçka që nuk do ta kuptojnë kurrë. S'arrij ta kuptoj pse gjithë ky interesim rreth atë që askush nuk ka arritur ta zbulojë, për atë që ka qënë, është dhe do të mbetet misteri në i madh i të gjitha kohërave. Perse duhet humbur koha? Perse duhet të shkojë dëm gjithë ky angazhim për një arsye, e cila zhvlerësohet e gjitha përpara tij? Nuk arrij të kap thelbin e mendimeve sa herë që bisedoj me ndonjë «maniak» për këtë problem. Tezat që ai shtron për të mbrojtur mendimet e tij më duken të gjitha pa vlerë. Jam munduar shumë për të kuptuar arsyen, pa e kuptuar edhe vetë se po bëhesha si ata. Unë që e vlerësoja aq shumë kohën, që e çmoja aq sa doja t'i ndër-gjegjësoja edhe të tjerët, të cilët e shpenzonin atë për gjëra të kota, për të mos vepruar kështu, i o e humbisja për të njëjtat arsye. Po mundohesha të kuptoja diçka që ishte e pa kuptueshme nga ana ime. Po humbisja kohë. Çudi, ç'më shtynte të veproja në të tillë mënyrë?

207

1911

1911